

## DPS takohet me përfaqësues të kompanisë “ANTEA Cement”

Më datën **27 Mars 2015**, në kuadrin rritjes së ndërgjegjësimit mbi rolin dhe rëndësinë e standardeve në produktet dhe shërbimet e ofruara në treg, për të rezultuar në një përfshirje më të madhe të biznesit në procesin e standardizimit, Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit (DPS) realizoi një takim në ambientet e kompanisë ANTEA Cement Sh.A me disa përfaqësues (shqiptarë dhe të huaj) të kësaj kompanie.

Në këtë takim, nga DPS morën pjesë Znj. Kostanca Dedja – Drejtore, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënies me Palët, Znj. Anita Reçi – Specialiste në Sektorin e Promovimit dhe Marketingut dhe Z. Neiron Zaçe – Përgjegjës në Sektorin CENELEC/IEC, ndërsa nga ANTEA




Cement ishin të pranishëm, Znj. Eldisa Shehu – Përgjegjëse laboratorit dhe Z. Giorgos Batsakis – Drejtori i Fabrikës, Z. Dimitris Periklopoulos – Drejtor për Mirëmbajtjen dhe Z. Xhafer Onuzi – Zv. Drejtor për Energjinë Elektrike.

Bashkëpunimi me ANTEA Cement Sh.A ka filluar më herët, fillimisht si blerës i standardeve dhe pastaj si lektorë me prezantim në Ditën Botërore të Standardeve 2014.

Kompania ANTEA Cement, duke njohur rëndësinë e standardeve ka kërkuar të bëhen anëtarë në punën teknike të DPS, si pjesë e Komiteteve Teknike. Kjo kërkesë do të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme të Bordit Teknik të DPS-së.

## Grupi TITAN – ANTEA Cement Sh.A

ANTEA Cement Sh.A. është një ndër investimet (Greenfield) më të mëdha të Grupit TITAN, në Shqipëri. Ndërtimi i fabrikës filloi në vitin 2008 në Fushë Krujë dhe përfundoi në 2010-ën. Po në vitin 2010 u prodhuan klinkeri i parë dhe filloi shitja e çimentos në vend dhe export, aktualisht me një kapacitet prodhimi rreth 1.5 milion tonë çimento në vit.



ANTEA Cement Sh.A ka ngritur dhe punon sipas një **Sistemi të Integruar Menaxhimi**, i cili ka implementuar standardet:

1. BS OHSAS 18001: 2007, Shëndeti dhe Siguria në Punë;
2. S SH EN ISO 9001: 2008, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë;
3. S SH EN ISO 14001: 2004, Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit;
4. Social Accountability 8000: 2008, Përgjegjësia sociale e korporatës.

Gjithashtu ANTEA përdor edhe një grup standardesh që mbulojnë procese të caktuara të punës së saj (P.sh. S SH EN 197-1:2011 – Përbërja, karakteristikat dhe kriteret e konformitetit për çimentot e zakonshme).

Nga ana e DPS u paraqitën dy prezantime:

1. **“Standardizimi në Shqipëri”** – prezantuar nga Znj. K. Dedja.

Prezantimi kishte karakter informues rreth DPS-së, kuadri ligjor, misioni, statusi në organizmat Evropine dhe Ndërkombëtare, adoptimi i standardeve, shitja e standardeve si dhe përfitimet e SME-ve nga përdorimi i standardeve etj.

2. **“Eficiencia e energjisë – standardi SSH ISO 50001”**, prezantuar nga Z. N. Zaçe, në cilësinë e sekretarit të Komitetit Teknik Nr. 3 - Materiale elektrike dhe elektronike, nga i cili janë adoptuar standardet e Familjes ISO 50000: “Menaxhimi i Energjisë”.

Në përfundim të prezantimeve dhe diskutimeve, duke marrë parasysh arritjet e kompanisë në implementimin e Sistemeve të Menaxhimit, nga DPS u sugjerua ngritja e një Sistemi për Menaxhimin e Energjisë në drejtim të rritjes së performancës dhe Eficiencës së Energjisë duke e integruar atë me Sistemet e tjera të Menaxhimit.

Gjithashtu, DPS prezantoi të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion (tel., fax., faqja e internetit, Profilet e DPS-së në mediat sociale) dhe shërbimet që ajo ofron; si dhe dorëzoi kopje të publikimeve: Rreth DPS (misioni, organizimi, të rehat, kontakte etj), botime mbi rëndësinë dhe përfitimet nga përdorimi i standardeve dhe krijimin e përfitimeve nga standardet për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME-të) dhe materiale promocionale.

Përfaqësuesit e kompanisë siguruan mbi vazhdimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit me DPS-në.